

Curriculum Vitae
Emri: Hava
Mbiemri: Bujupaj- Ismajli
Datëlindja: 26.11.1960 - Istog
Telefoni: 044-655-400
E- mail: havaismajli@hotmail.com

Në vitin 1979/80 u regjistrua në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Gjatë studimeve si shenjë mirënjohjeje për suksesin e treguar në studime dhe aktiviteteve të tjera, Universiteti i Prishtinës me datën 17.02.1983, i ndau diplomën: “Student i dalluar”.

Në qershor të vitit 1983, diplomoi në Fakultetin Juridik, me notën mesatare 9,00. Pas diplomimit u punësua si praktikante në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Më vonë punoi në “FERONIKEL”, si përfaqësuese juridike e kësaj ndërmarrjeje.

Në tetor të vitit 1988 u pranua në Fakultetin Juridik si asistente në lëndën: “E drejta e punës dhe sigurimi social”.

- **Në vitin 1988/89**, - regjistroi studimet pasuniversitare në drejtimin Administrativo-Politik. Provimet e shkallës së tretë i kryen në vitin 1991. Më 24.06.1993, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit, i lejon punimin e temës së magjistraturës me titull: “Liria dhe pavarësia sindikale si faktor me ndikim në përmirësimin e pozitës juridike dhe faktike të punëtorëve”. Me vendim të Këshillit Mësimor Shkencor (Nr.01/87-1 të dt.28.12.1995), me datën 03.01.1996 mbrojti me sukses temën e magjistraturës.

Në vitin 1998, zgjedhet ligjëruese për lëndën: “E drejta e punës dhe e drejta e sigurimit social” ku edhe tani punon.

Me dt.26.06.1998, në bazë të vendimit të Këshillit Shkencor – Mësimor i lejohet tema e doktoratit me titull: “Zhvillimi dhe perspektiva e negociatës-kolektive në shoqërinë pasindustriale”. Të cilin e ka mbrojtur me sukses të dalluar në korrik të vitit 2003, ka bashkëpunuar me “Vjetarin” dhe revistën “E drejta”, dhe ka botuar punimet në vijim:

- Përgjegjësia materiale e punëtorëve në punë (Revista E Drejta nr.2,1994)
- Organizimi dhe veprimtaria sindikale në Kosovë në periudhën prej vitit 1936 gjer më sot – Vjetari, 1995.
- Lindja dhe zhvillimi i së Drejtës së punës në fazat e ndryshme të tranzicionit (Revista E drejta nr.1.1997).
- Disa aspekte të politikës sociale në botë (Revista E drejta, nr.2-1996).
- Korporatat ndërkombëtare, sindikatat dhe negociatat kolektive (revista E drejta, nr.1 -2006”

Ka botuar dy tekste mësimore :

- E drejta ndërkombëtare e punës, shtator 2001, dhe
- E drejta e punës, Prishtinë 2005

Gjatë punës në Fakultet, ka ushtruar disa funksione : Sekretar katedre, shefe katedre dhe gjithashtu ishte anëtare e disa komisioneve të tjera në fakultet. Prej marsit te vitit 2007 e gjer më 1 tetor të vitit 2009 ka qenë Dekane e Fakultetit Juridik të UP-s.

Ishte pjesëmarrëse në konferencën rajonale të organizuar nga Sindikata e pavarur e pensionistëve të Kosovës në nëntor të vitit 2003, në këtë konferencë mori pjesë me kumtesën me titull: “Normat minimale nga sigurimi social dhe praktika e aplikimit të tyre në vendin tonë” e cila u botua nga po e njejta sindikatë në vitin 2004, poashtu mori pjesë në shumë seminare dhe trajnime si në vend ashtu edhe jasht vendit, ka kryer trajnimin për zhvillimin e administratës bashkëkohore, në Pragë në nëntor të vitit 2001.

Në EU- Qëndrore ka marrë pjesë në trajnimin për metodologjinë e mësimdhënies në vitin 2000.

Ka patur vizita në disa universitete të Evropës me qëllim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave si në Austri, Gjermani, Suedi, Turqi e poashtu edhe ne disa vende tjera të rajonit.

Gjate periudhes sa ishte Dekane realizoi shumë projekte me interes të përgjithshëm si:

- Reformimin e planprogramit mësimor të Fakultetit Juridik në bashkpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit të Gracit dhe

Fakultetit Juridik të Universitetit të Orebros- Suedi. Ky reformim pati për qëllim ndryshimin e sistemit të studimëve nga 3+2 në 4+1.

- U ndërtua Gjykatorja e Fakultetit Juridik e cila konsiderohet si një ndër Gjykatoret ma moderne në Rajon, e dedikuar për praktikë të studentve të Fakultetit Juridik.

- Me ndihmën e organizatave dhe institucioneve të SHBA-ve që veprojnë dhe punojnë në Kosovë u realizuan edhe shumë projekte të tjera si: paisja e bibliotekës me kompjuter dhe me tekste që i shërbejnë studentve për studime sa më cilësore. Marrë në tërësi gjatë mandatit tim investimet në Fakultetin Juridik kanë qenë diku rreth 800.000 mijë € të gjitha keto në cilësi të donacioneve.

- Për shkak të kontributit që i dha Fakultetit Juridik të UP-s, në jubileun e kremtimit të 90 vjetorit të themelimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Lublanes, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës ishte ndër 10 Fakultetet Juridike të rajonit dhe evropës që u shperbly me medalje.